

1. Mbi qeverisjen (zhvillimet historike të saj).

Klasifikimi i Platonit mbi qeverisjen

Qeverisje e bazuar ne ligj	Qeverisje pa ligj
Monarki	Tirani
Aristokraci	Oligarki/ Timokraci
Demokraci e Moderuar	Demokraci Ekstreme

Timokracia ndeshet:

Kur vetem pronaret marrin pjese ne qeverisje,

Kur nderi dhe dashuria behen parim udheheqes ne qeverisje.

Forma me ekstreme e timokracise, ku jo nderi por pasuria behet burim i pushtetit shnderrohet ne **plutokraci** (ku te pasurit nepermjet perdorimit te fuqise prej tyre e rrisin me tej kete pasuri)


Klasifikimi i Aristotelit mbi qeverisjen

Si pergjigje ndaj pyetjeve: Kush drejton dhe kush perfton?

Forma e Kushtetutes	Kush udheheq		
	Nje	Pak	Shume
	E vertete	Mbreteri	Aristokraci
E deform.	Tirani	Oligarki	Demokraci

Per Aristotelin:

- **Tirania** ishte forma me e keqe e qeverisjeve te mundshme, bile duke synuar kthimin e qytetareve ne skllaver.
- **Monarkia dhe Aristokracia** nuk ishin sisteme praktike ne deshiren per te vendosur interesat e komunitetit perpara atyre te vete udheheqesve.
- **Politea** eshte qeverisje nga shumica ne interes te te gjitheve, si e tille, per Aristotelin ajo ishte forma me praktike midis formave te mundshme. Pra, **tipi ideal i sistemit politik** ishte ai qe kishte te nderthurur elementet e te dy formave qeverisese: **demokracise dhe aristokracise**. Nje kushtetute e tille e nderthurur e le qeverisjen ne duart e **shtresimeve (klasave) te mesme**.



Klasifikimi i Platonit mbi qeverisjen

Qeverisje e bazuar në ligj	Qeverisje pa ligj
Monarkia	Tirania
Aristokracia	Oligarkia/ Timokracia
Demokracia e Moderuar	Demokrasi Ekstreme

Klasifikimi i Aristotelit mbi qeverisjen: Si pergjigje ndaj pyetjeve: cili drejton dhe cili përfton?

Forma e Kushtetutës	Cili udhëheq?			
		Një	Pak Njerëz	Shumë Njerëz
	E vërtetë	Mbretëria	Aristokracia	Politea (Πολιτεία)
E deform.	Tirania	Oligarkia	Demokracia	

Elemente fillestare të qeverisjes demokratike te Athinës (Demokracia e drejtperdrejte).

Athina ka lëvizur në mënyrë graduale drejt disa rregullave demokratike.

Kështu, aristokracia athinase **ka qeverisur nëpërmjet një këshilli të drejtuar nga “archon” - ët** (“archon” një zyrtar apo magjistrat i lartë, një drejtues apo figurë me autoritet, një nga nëntë magjistratët kryesorë të Athinasve të vjetër, të zgjedhur nga familja udhëheqëse për të mbikëqyrur jetën civile dhe fetare të qytetit). Pra, në atë kohë vetëm familjet aristokratike **kishin zë në qeverisje**.

Më 621 p.e.s – arkonët kërkuan hartimin e një **kodi ligjesh**. Sipas këtij kodi të gjitha ligjet duhet **të aplikoheshin tek të gjitha klasat** dhe parashikonin penalitete të ashpra.

Më 594 p.e.s – iu dha **liria skllëvërve** duke i kthyer ata në qytetarë të lirë, **u kufizua madhësia e tokës** në dispozicion të një individi (si pronë e tij) dhe po ashtu **u uljen çmimet e ushqimeve**. Me anë të këtyre reformave “**qytetari i zakonshëm**” fitoi më **shumë fuqi politike**.

Më 508 p.e.s- u krijua **Asamblenë e Athinës** - një trupë për hartim ligjesh. ku iu dha e drejta të gjithë qytetarëve që të merrnin pjesë në të. Po ashtu, u fut dhe **ideja e ostracizmit**, të largimit (dëbimit) apo dërgimit në ekzil të qytetarëve që shiheshin si një kërcënim ndaj komunitetit.

Demokracia athinase

- **Ndër regjimet politike, më të dokumentuar, të lidhur me emrin e demokracisë, është ai i qytetit të Athinës.** Ai përbën dhe një nga eksperimentet njerëzore më spikatese të demokracisë së drejtpërdrejtë, ku njerëzit nuk zgjedhin përfaqësuesit e tyre për të votuar për ta, por **votojnë drejtpërsëdrejti ligjet dhe faturat ekzekutive në shërbim të tyre.** Në fillim vota nuk ishte si një mënyrë e drejtpërdrejtë e përcaktimit të përgjegjësve politikë, **por shfrytëzohej shorti, një hedhje ose tërheqje e rastit.** Kjo quhej ndryshe *stokokraci*. Madje, sipas Aristotelit, në kuadër të demokracisë, bëhej fjalë për **“zgjedhje pa dallim në të gjitha detyrat publike, sovranitet i ushtruar nga të gjithë mbi secilin dhe nga secili mbi të gjithë me turne, shorti si sistem për zgjedhjen e të gjithë magistratëve, ose të paktën e atyre që nuk duhet të kenë përvojë të specializuar ose kompetenca të veçanta,..., koha tepër e shkurtër në ushtrimin në të gjitha detyrat ose pothuajse në të gjitha”**... (Aristoteli, *Politika*, Konica 2003, f.73). [**Magnum opus** (apo *opus magnum*), ne lat. *Veper madhore* (e madhe)]
- Diku nga mesi i shekullit V p.e.s., në reformat e Perikliut ndeshet dhe **e drejta e votës.** Kjo e drejtë iu akordua vetëm qytetarëve, pra burrave të lindur nga baballarë athinas dhe nëna- bija të këtyre qytetarëve (përgjithësisht, mbi 20 vjeç, pas “shërbimit ushtarak” në moshë 18- 20 vjeç). Gratë, fëmijët, skllëvërit dhe të huajt, megjithëse përbënin shumicën e popullsisë së qytetit, nuk e gëzonin këtë të drejtë.

- Për të qenë një qytetar athinas duhej një origjinë e dyanëshme prindërore nga shteti (qyteti) i Athinës, duke përjashtuar kështu fëmijët me baba athinas dhe mama të huaj. **Qytetaria jepej nga asambleja, fillimisht për grupe të mëdhenj dhe më vonë vetëm në mënyrë individuale nga një votim special brenda një kuorumi prej 6000 pjesëtarësh, si shpërblim për shërbime konkrete ndaj shtetit (qytetit).** Ndërsa, skllëvërit, gratë apo të huajt ishin të përjashtuar nga bashkësia politike, pra dhe e drejta e votës, në shumicën e qyteteve greke.
- Sipas vlerësimeve të asaj kohe ndesheshin afro 40 000 zgjedhës për 250 000 banorë. **Sidoqoftë, në këtë model të demokracisë së drejtpërdrejtë nuk votohej për të zgjedhur përfaqësuesit e popullit me qëllim që të pasqyrohej e mishërohej nëpërmjet tyre interesat e tij, por votohej nga qytetari për vetveten, p.sh., për legjislacionin, ligjet apo vendimet në shërbim e interes të tij.**
- Ekzistonin **3 trupa politikë** ku mund të mblidheshin qytetarët. Ata ishin **asambleja** (me një kuorum prej 6000 qytetarësh), **këshilli** (prej 500 anetarësh) dhe **gjykata** (me një një numër minimal prej 200 deri në 6000 qytetarë). Por, **thelbi i vërtetë i demokracisë athinase ka qenë asambleja; madje mbledhja e saj përbënte një ngjarje të madhe.** Po ashtu, vlen të nënvizohet se asambleja ka realizuar, të paktën, **katër funksione kryesore**: i. **vendimmarrje ekzekutive e juridike (dekrete, p.sh., për shpallje lufte, vajtje në luftë, dhënie shtetësie);** ii. **zgjedhje zyrtarësh,** iii. **përgatitje e miratim ligjesh;** dhe iv. **gjykime e dënime krimesh politike.** Me evolucionin e sistemit, proceset e fundit u zhvendosën tek **gjykatat.**
-

-3-

- Ndryshe nga parlamentet e sotme, qytetarët e rritur, anëtarë të asamblesë athinase, **nuk ishin të zgjedhur**. Ata merrnin pjesë në mbledhje të saj me **deshiren e tyre**, por dhe duke e konsideruar atë **si detyrë** (detyrimi bëhej shumë më i prerë, **kur nuk plotësohej kuorumi prej 6000 qytetarësh**, bile, për mospjesëmarrje në asamble me vone duhej të paguhej një gjobë e veçantë). Në votim, pozicionimi individual konkret me *po* ose *jo*, bëhej zakonisht me dorë (me shtrirje apo ngritje dore - **cheirōtonia**), dhe me **shumicë të thjeshtë**. Me që, në prani të disa mijëra njerëzve, numërimi bëhej i vështirë (sidomos kur votimi ishte i gati balancuar midis *po*-së dhe *jo*-së), për të mundësuar këtë numërim përdroreshin gur të vegjël dy llojesh: **gurët e bardhë për votën pro (po) dhe ata të zi për votën kundra (jo)**. Qytetarët i hidhnin këta gur në poçe balte, për t'i numëruar më pas. Shtojmë se në shekullin e 5-të p.e.s., organizoheshin 10 mbledhje në vit (një për çdo muaj të quajtur **shtetëror**), por po të nevojitej thirreshin dhe mbledhje shtesë. Në shekullin pasues numri i këtyre mbledhjeje u bë më i madh (me 4 mbledhje në çdo muaj shtetëror).
- Në qytete-shtete të tjerë numri i votuesve ishte dhe më i kufizuar, sepse të drejtën e votës e gëzonin vetëm ata qytetarë që zotëronin toka apo kishin shtëpitë e tyre.


Shorti

- Në Athinë, në rastin e dënimeve publike, shfrytëzohej “*plurality vote*” apo marrja e votave më të shumta, ku qytetari për gabimet dhe fajet e tij, i dërgohej në ekzil për një periudhë 10 vjeçare (i ashtuquajtur *ostracizëm*).
- Shumica e zyrtareve dhe magjistrateve të qeverisë së Athinës përcaktoheshin me short, kurse zgjidheshin *gjeneralet* apo *strateget* (*stratego*) dhe disa *zyrtare të vecante*
- **Stokokracia** vjen nga greq. *kratein*, (për të drejtuar, për të qeverisur) dhe *stokhastikos* (e rastit), për të nënkuptuar hedhjen e shortit për qeveritarët qendrorë apo vendorë sipas konceptimit të demokracisë athinase. Mund të shfrytëzohet si koncept dhe “klerokracia” ku prefiksi vjen nga shkurtimi i fjalës greke *cleroterion*, për një pajisje apo makinë që shërbente për të hedhur shortin për magjistratët në Athinë. **Kleroterion** ishte një pajisje e përdorur nga qytetarët e Athinës gjatë periudhës demokratike për zgjedhjen e rastit të qytetarëve - anëtarë në juritë ditore. Siç duket nga fotoja ajo ishte një sipërfaqe e sheshtë me mjaft çarje ku mund të futeshin *pinakia*- si dhe një tub (poçe) që mbushej me gure (sfera) të ngjyrosur që kur vepronte në mënyrë mekanike përcaktonte çarjet që duhet të zgjidheshin.
- **Pinakon-i** (sh. *pinakia*) apo pllakë e vogël **bronzi** për të identifikuar qytetarin e një shteti (qyteti). Pinakia për kandidatët e një zyre politike apo anëtarësinë në një juri futeshin në mënyrë të rastit në *kleroteria*.
-



Judicial Procedure

- Kur caktohej gjyqi nga magjistrati (**personi publik per zbatimin e ligjit**), nje numer i madh anetaresh potencial jurie (**dikastai**) vinin ne vendin e caktuar ne Agora (gr. : Ἀγορά, Agorá) apo ne vendin e hapur te asamblese. Cdo njeri prej tyre kishte **nje karte apo “bilete” bronzi (pinakion)** me emrin e tij, te babait dhe te zones ku ishte regjistruar. Ky anetar potencial jurie fuste biletën e tij ne makinën e shortit (**kleroterion**), ne seksionin e tribuse (fisit) te tij. **Procedura:** Magjistrati merrte nje grup biletash dhe i fuste ne carjet e tribuse perkatese. Pastaj ai hidhte nje perzierje guresh apo sferash te vogla mermeri te zi dhe te bardhe ne pjesen e sipërme te nje inke bronzi me tub te ngushte qe zbriste anash se kleroterionit (fig.). Kur kthehej leva dhe sfera prej mermeri ishte e bardhe te gjithë personat e atij reshti percaktoheshin si anetare jurie, po te ishte e zeze, per ate dite ata perjashtoheshin nga kjo detyre. Procedura vazhdonte deri sa te caktohej i gjithë numri i nevojshem i dikastai-ve (nisur nga 200 per cdo juri deri ne 6000). Pas kesaj procedure cdo anetar i perzgjedhur ne kete menyre pajisej me nje “monedhe” gjyqi (**symbolon**) me germen qe percaktonte gjyqin ku ai do te merrte pjese. Ne fund te dites, ai dorezonte symbolon dhe merrte pagesen per sherbimin e tij.



Republika Romake

- Roma, fillimisht, qeverisej **nga mbretër, të zgjedhur nga fiset kryesore**. Krahas autoritetit mbretëror, funksiononin edhe **tre asamble përfaqësuese: *Senati***, që vepronte si një **trup këshillues** i mbretit; ***Comitia Curiata***, që miratonte dhe ratifikonte ligjet e sugjeruara nga mbreti; dhe ***Comitia Calata***, që ishte një kuvend i kolegjit priftëror.
- **Me kalimin nga mbretëria në republikë, ndarja klasore e shoqërisë romake u shfaq si një përzierje e pazakontë demokracie e oligarkie**. Ajo u bë më e spikatur gjatë perandorisë.
- Pra, po të përmblihet me pak fjalë, qytetërimi romak gjatë ekzistencës së tij u zhvendos fillimisht **nga monarkia në një republikë oligarkike dhe më tej në një perandori autokratike në rritje**.
- Gjatë këtij evolucioni, vetë shoqëria romake ka shfaqur tipare të qarta hierarkike: **skllevërit, ish skllevërit të lënë të lirë dhe qytetarët e lindur të lirë**. Kurse, ndarja më e hershme në monarki ka qenë ndërmjet **patricëve** (me origjinë të lidhur me patriarkët themelues të qytetit) dhe **plebenjve** (që nuk e kishin këtë prejardhje), por vetë ajo ndarje u bë më pak e rëndësishme nga fundi i republikës, sepse disa **familje plebenje u bënë mjaft të pasura dhe me lidhje të forta politike**, ndryshe nga disa familje patrice në vështirësi ekonomike të konsiderueshme. Aq më tepër, kur një plebe bëhej konsull, gje që fisnikëronte të gjithë pasardhësit e tij! Megjithatë, origjina patrice, vazhdonte të jepte një prestigj shumë të lartë, madje shumë poste fetare vazhdonin t'i kishin vetëm për patricët.

- **Po aq tipike ka qenë ndarja e klasave në shërbimin ushtarak.** (Anëtarësia klasore konkrete përcaktohej aty nga **çenzorët**, sipas pasurisë e pronave. Më të pasurit ishin **senatorët**, që dominonin politikën dhe kishin komandën e ushtrisë; pastaj vinin **ekuestrianët ose ekuitët (kalarësit)** nga të cilët u formësua një klasë tregtarësh, pastaj vazhdohej me shtresime të tjera të lidhura me mundësinë e përballimit të veshjes dhe armatimit të nevojshëm, duke e mbyllur këtë radhitje me **proletarii** apo qytetarët, që nuk kishin fare pronë, bile këta të fundit, përpara reformave të Mariusit nuk mund të kryenin as shërbim ushtarak).
- **Me këtë ndarje klasore lidhej dhe pushteti i votës në republikë.** Qytetarët regjistroheshin në **grupe votuese** (por grupet e klasave të pasura kishin më pak anëtarë se ato të njerëzve më të varfër, kurse të gjithë proletarii duhej të regjistroheshin të gjithë në një grup të vetëm). Votimi kryhej sipas radhës së klasave dhe ndalonin kur shumica e grupeve kishin votuar, duke bërë që klasat më të varfra edhe të mos votonin fare. Ndërsa, ndaj qyteteve të huaja aleate shpesh aplikoheshin **e Drejta Latine**, që nënkuptonte një nivel ndërmjetës midis qytetarëve me të drejta të plota dhe të huajve, por që u mundësonte atyre mjaft të drejta të ligjit romak - ndër to lejimin e magjistratëve kryesorë të tyre që të bëheshin qytetarë me të drejta të plota. Ndërsa kishte disa nivele të ndryshme të kësaj të drejte latine, ndarja kryesore ishte midis **cum suffragio** (“me votë”); që nënkuptonte regjistrim në grupe votuese dhe që kishin mundësi të merrnin pjesë në **comitia tributa** dhe **sine suffragio** (“pa votë”); që nuk kishin mundësi të merrnin pjesë në politikën romake. **Femrat kishin disa të drejta bazë krahasuar me meshkujt, por nuk konsideroheshin qytetarë me të drejta të plota, prandaj nuk lejoheshin të votonin ose të merrnin pjesë në jetën politike, edhe pse njihen mjaft shembuj peshë në historinë e Romës, ku vulën kryesore e ka lënë drejtpërsëdrejti apo tërthorazi ndikimi i tyre.**

- Sipas të dhënave (shihni, p.sh., Frank Burr March; revised by H.H. Scullard. *A History of the Roman World From 146 to 30 B.C.* London: Methuen & Co. Ltd., 1971), në Republikën Romake ishin dy asamble qytetare: **Asambleja Ushtarake apo Comitia Centuriata** dhe **Asambleja Tribale (e tribuve, e fiseve) apo Comitia Tributa**. Asambleja e fundit apo e plebenjve përfaqësonte 35 tribu; prandaj ajo ishte e ndarë në 35 blloqe. Në vitin 494 p.e.s., prej liderëve të këtyre blloqeve u krijua **zyra e Tribunit të popullit** (lat. “*tribunus plebis*”), pikërisht për të mbrojtur plebenjt nga abuzimi i magjistratëve patricë, prej të cilëve ata u larguan nga Roma. Vetë tribunët e popullit zgjidheshin nga **Këshilli i Plebenjve** (lat. *concilium plebis*), i përbërë vetëm nga plebenj, si një nënansamble e Comitia Tributa. Sidoqoftë, ky këshill nuk ishte tamam zyrtar sepse nuk përfaqësonte të gjithë qytetarët e Romës, por vetëm njerëzit e thjeshtë. Tribuni që drejtonte këshillin mund të propozonte shqyrtimin aty të çdo ligji (të ashtuquajturin plebishit). Në vitet e para, këto ligje të pranuar në këshill preknin vetëm plebenjtë, por më vonë ato preknin të gjithë romakët. Gjithashtu, me kalimin e viteve, tribunët fituan dhe fuqi të tjera, deri dhe atë të vetos ndaj çdo veprimi apo propozimi të një magjistrati tjetër, përfshirë atë një tribuni populli. Për më tepër, tribuni kishte fuqinë e ushtrimit të detyrimit kapital kundër çdo individ që cenonte kryerjen e detyrave të tij.
- Comitia Tributa, nën drejtimin e një tribuni, mbledhej në **Forum Romanum** për çështje të ndryshme, **veçse për të votuar çdo anëtar duhej të ishte fizikisht i pranishëm në sitenë e Romës**. Gradualisht, kjo asamble u bë dhe fuqia bazë e Republikës Romake. Nëpërmjet saj zgjidheshin **magjistratët financiarë** të njohur si **kuestorë** dhe **curule aedile**. Ndërsa , në një pjesë kryesore të kohës kjo asamble ka trajtuar edhe probleme juridike.

- Republika Romake u krijua aty nga viti 509 p.e.s., me zëvendësimin e mbretit me një sistem qeverisje të mbështetur tek magjistratët e zgjedhur dhe disa asamble përfaqësuese. **Nëpërmjet një kushtetute përcaktohej një varg kontroll-balancimesh dhe ndarje fuqie.** Kështu, në kushte normale, autoriteti më i lartë ndahej midis dy konsujve, ndërsa në kushte emergjence emërohej një **diktator**. Pra, magjistratët më të rëndësishëm ishin **të dy konsujt**, që ushtronin së bashku detyra ekzekutive në trajtë autoriteti e fuqie (**imperium**) apo **komande ushtarake**. Ata duhej të bashkëpunonin ngushtë me senatin, që në fillim luante rolin e një organi këshillimi, të përfaqësuar fillimisht nga patricët, por që gradualisht u rrit në përmasë, shtrirje e fuqi. Magjistratë të tjerë të republikës ishin: tip “**prefektësh**” apo **pretorët** (zyrtarë të lartë, të emëruar apo zgjedhur në detyra të ndryshme në qendër apo provincë); **edilët (aediles**, që përgjigjen për ndërtesat publike, rendin publik apo festimet e ndryshme) dhe **kuestorët** (zyrtarët e zgjedhur për çështje financiare). Fillimisht, këto pozicione u takonin patricëve por më vonë ato u bënë të hapura dhe ndaj njerëzve të thjeshtë apo plebenjve. Shtojmë se nëpërmjet votimit kompozoheshin edhe dy asambletë kryesore: **comitia centuriata (asambleja ushtarake)** që votonte për çështje të luftës dhe paqes dhe zgjidhte njerëzit për detyrat më të rëndësishme të republikës dhe **comitia tributa (asambleja tribale)** apo asambleja e plebenjve, që zgjidhte njerëzit për detyra më pak të rëndësishme.
- Në Republikën Romake **diktatori ishte një magjistrat i jashtzakonshëm (magistratus extraordinarius)** me një autoritet absolut në kryerjen e detyrave ndryshe **nga një magjistrat i zakonshëm (magistratus ordinarius)**. Zyra e tij ishte një ndryshim ligjor i të njëjtës zyre që fillimisht u quajt **Magister Populi**. Vetë **Senati Romak, nëpërmjet miratimit të një senatus consultum** iu autorizon konsujve të emërojnë një diktator, madje një autorizim i tillë është i vetmi që prek **dy parimet bazike e legale romake: parimin e kolegjalitetit (angazhim i shumëfishtë brenda një zyre) dhe parimin e përgjegjshmërisë apo responsabilitetit (përgjegjësia ligjore për veprimtarinë zyrtare)**. Pra, bëhet fjalë për një emërim të vetëm si magjistrati më i lartë, që **nuk mban përgjegjësi legale ndaj veprimeve zyrtare.**

-5-

- Ligjet romake tradicionalisht mund të kaloheshin vetëm nga vota e asamblesë plebejane: *Comitia Tributa*. Gjithashtu, kandidatët për poste publike duhej të garonin në zgjedhje. Gjithsesi, Senati romak përfaqësonte një institucion oligarkik, që vepronte si një trupë këshilluese, vecse në Republikë, ai kishte një autoritet shumë të madh, edhe pse nuk zotëronte fuqi direkte legjislative (teknikisht ishte thjesht një trupe këshilluese). **Gjithsesi, meqenëse senatorët kishin shumë ndikim, ishte e vështirë që të kryeje ndonjë gjë kundër vullnetit kolektiv të Senatit.** Senatorët e rinj zgjidheshin nga patricët më të kualifikuar, nga çenzorët, që gjithashtu mund të largonin një senator nga zyra e tij nëse vertetohej se ishte moralisht i korruptuar; një akuzë ishte p.sh. ryshfeti. Pikërisht për t'iu kundërvënë situatave të tilla, në vitin 218 p.e.s. u miratua një ligj, i hartuar nga **Quintus Claudius**, në atë kohë tribun populli, me të cilin ndaloheshin anëtarët e senatit të përfshiheshin në tregti, kështu që kur nje equestrian mund t'i bashkohej teorikisht senatit ai duhej të ishin tepër i kufizuar në kuptimin e pushtetit politik. Ndërsa, me rënien përfundimtare të republikës (aty nga viti 27 p.e.s.) fillimisht u ruajtën, edhe pse pa përmbajtje reale, **format republikane të qeverisjes.**
- **Perandori romak konsiderohej thjesht si princeps** ose qytetar i parë. Senati “mori vetë në dorë” pushtetin legjislativ dhe të gjithë autoritetin ligjor që më parë e mbanin asambletë popullore. Gradualisht, sundimi i perandorëve u bë gjithnjë më autokratik, madje dhe **senati u reduktua në një trupë këshilluese të përcaktuar nga perandori.**

Kushtetuta e Republikës Romake

Comitia Centuriata- Asamble Ushtarake në të cilën ushtarët janë të ndarë në blloqe qindëshe- *centuries*. Çdo bllok i tillë në asamble ka një votë, kurse çdo ushtar aty ka një pozicion të përcaktuar sipas pronës që ka në zotërim. Me që në shumicën e këtyre qindsheve grupohen ushtarët më të pasur, kjo asamble rezulton tepër aristokratike.

Senati

Në praktikë, ai luan një rol qendror në funksionalitetin e përditshëm të Kushtetutës. Në gjirin e tij janë të përfshirë politikanët më me përvojë. Është ai që përcakton politikën e jashtme dhe atë ushtarake, krahas orientimit të politikave të brendshme.

Comitia Tributa -Asamble qytetarësh e ndarë në blloqe (fise), seicili prej tyre ka një votë në asamble; aty votojnë si patricët, ashtu dhe plebejt.

Nga mënyra e përfaqësimit të qytetarëve në këto blloqe sipas vendndodhjes gjeografike dhe jo klasifikimit sipas pronës e pasurisë, kjo asamble është më pak aristokratike se **Comitia Centuriata**. **Concilium Plebis** është një derivat i kësaj asambleje.

Concilium Plebis

Ai është pothuajse identik me **Comitia Tributa**. Diferenca e vetme është se ky Këshill drejtohet nga një **Tribun** dhe kompozohet nga plebej. Pas vitit 287 p.e.s. çdo akt i miratur në atë këshill duhej të zbatohet nga të gjithë (senati dhe populli i Romës).

Magjistratët Ekzekutivë

Comitia Centuriata zgjedh magjistratët më të lartë

Senati axjerr udhëzime për të gjithë magjistratët veç tribunëve

Censorët mund të shktojnë anëtarë të rinj në Senat apo t'i përjashtojnë ata

Comitia Tributa zgjedh magjistratët më të ulët

Concilium Plebis zgjedh magjistratët Plebej

Konsujt

Pretorët

Censorët

Çdo magjistrat ka veto mbi çdo veprim të një magjistrati të nivelit të njëjtë apo me të ulët

Kuestorët

Curule Aediles

Tribunët kanë veto mbi çdo akt të **Comitia Centuriata**, **Comitia Tributa**, **Concilium Plebis** ose **Senatit**

Tribunët Plebej

Aediles Plebej asistojnë Tribunët Plebej

Aediles Plebej

Por ç'është Fuqia Politike?

- Fuqia politike (**imperium**- lat.) është një tip fuqie e mbajtur apo drejtuar nga një grup në një shoqëri , që lejon administrimin e veprimtarive apo burimeve publike, përfshirë punën dhe shëndetin. Ekzistojnë mënyra të ndryshme të zotërimit të këtyre fuqive apo pushteteve. Në nivelin e shtetit - komb legjitimiteti politik për fuqinë politike u *takon* **përfaqësuesve të sovranitetit kombëtar**. Fuqitë politike nuk kufizohen tek kryetarët e shteteve.
- Megjithatë shtrirja tek një person or grup kryengritës, terrorist apo korporatë shumënacionale lidhet dhe me ndikimin formal apo informal, të drejtpërdrejtë apo tërthor të tipit grupor ose shoqëror. **Në shumë raste ky ndikim nuk realizohet brenda një vendi të veçantë, në këtë rast bëhet fjalë për një fuqi apo pushtet ndërkombëtar.**
- **Në shkencat politike fuqia është “aftësia apo kapaciteti për të ndikuar mbi sjelljen e të tjerëve” me ose pa rezistencë.**
 - Pjesa e fuqise eshte **institucionalizimi**:
 - rregulla për marrje vendimesh të “lidhura”
 - reduktim të kostove dhe të pasigurisë
 - dhënie autoritare vlerash

Përse kemi nevojë për qeverisje?

Zgjidhje konfliktesh

- në lidhje me vlera
- në lidhje me zotërime

Furnizim të mirash publike

- Tregje dhe monedhë të qendrueshme
- Shërbime publike, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe edukimin
- Mbrojtje dhe rend
- Mbrojtje mjedisore

Garantim të të “drejtave natyrore”:

- jeta
- liria
- prona (fizike dhe intelektuale)

Alternativa të tjera për “qeverisje” (administrim) apo menaxhim konfliktesh

Të “fortët” – lordët e luftës, shefat e bandave, etj.

Lidhje gjaku - shoqëritë e vogla- lidhje familjare, përfitime reciproke

Rregulla trashëgimie – brenda klanit, sipas gjakut dhe fronit (monarkut)

Tregu – rregulla të plutokracisë së pasur

Meritokracia, njerëzit e mençur

Mandarinët konfuçianë, mbretërit e filozofisë së Platonit

Fetarët, magjistarët, p.sh., priftërinjtë, kadijtë e hoxhallarët, (ajatollahët në Iran), etj.

Plutokracia

- Plutokracia është një qeverisje nga të pasurit, apo njëzëz të fuqizuar nga pasuria. Në plutokraci shkalla e pabarazisë ekonomike është e lartë, ndërsa niveli imobilitetit social është i ulët. (Fjala *ploutokratia* (nga greq. moderne: πλουτοκρατία) derivohet nga rrenja e greq. së vjetër *ploutos*, që do të thotë **pasuri** dhe *kratein*, që do të thotë të qeverisesh apo të drejtosh).
- Termi **plutokracia** shfrytëzohet si koncept në dy forma të ndryshme: njëri me natyrë historike dhe tjetri me natyrë politike bashkëkohore.
- **I pari pasqyron kontrollin politik të shtetit nga oligarkia e njëzëzve të pasur.** Shembuj të kësaj plutokracie janë p.sh. qytetet –shtete në Greqinë e Lashtë, civilizimi kartagjenas, republikat tregtare italiane si Venecja, Firencja, Xhenova, etj.
- Një shembull modern, ndoshta unik, i formalizuar si plutokraci është **Siteja e Londres** apo **City of London**. (Kjo nuk është e gjithë Londra moderne por vetëm zona e vjetër e qytetit, që përfshin kryesisht distriktin financiar; ajo **ka një sistem elektoral unik**; shumica e votuesve aty janë përfaqësues të bizneseve dhe të trupave të tjera që okupojnë sipërfaqen e tij). Aty numri i votuesve është i pabarabartë. Justifikimi kryesor për **votën jo rezidente** është që afro 450.000 jorezidentë përbejnë popullsinë ditore të Sites dhe shfrytëzojnë të gjitha shërbimet e tij, numer ky shumë i madh në lidhje me numrin rezident aty që nuk kalon 10.000.
- **Përdorimi i dytë i plutokracisë ka reference pezhorative në lidhje me influencën disproporcionale të njëzëzve të pasur në procesin politik në shoqëri moderne.** Kështu, p.sh. Kevin Phillips, autor dhe strategjist politik i presidentit Nikson ka këmbngulur se SHBA-ja është në njëfarë mase një plutokraci në të cilin ekziston **“një fuzion, një shkrirje e parase dhe e qeverisjes”**.

Siteja e Londres (City of London)

Kjo site nuk eshte reformuar sipas Aktit te vitit 1835 per Korporatat Municipale, as me ndonje legjislacion pasues.

Ne vitin 1801 kjo site kishte nje popullsi prej afro 130,000 banoresh, por zhvillimi ne vazhdimesi i kesaj siteje si nje distrikt qendror biznesi coi deri ne renien drastike te ketij numri deri ne afro 5.000 vete pas Luftes se Dyte Boterore. Ky numer tashme ka kaluar 9,000 vetet, ne saje te zhvillimit te ndertimeve shume te ngjeshura ne nje zone rezidenciale me perqendrim financash e tregtie (perfshire Qendren e Arteve, Muzeun e Londres, etj.)

Ne rastin e kesaj siteje, vota jo rezidenciale (apo vota biznesore), qe eshte hequr ne te gjithe vendin ne vitin 1969, eshte bere thelbesore. Ne vitin 2009 kjo vote biznesi kapi gati nje elektorat prej 24,000 votuesish, duke kapercyer qartesisht numrin e votuesve rezidente.

Teori mbi qeverisjen dhe shtetin

- • **Teoria e Forcës:** - populli merr kontrollin dhe drejton nëpërmjet fuqisë së vet.
- • **Teoria Evolucionare:** – shteti është zhvilluar si një familje e madhe e hershme
- • **Teoria e të Drejtës Divine:** – Zoti u ka dhënë të drejtën e sundimit atyreve që kanë **gjak mbretëror** (me trashëgimi mbretërore sipas lindjes)
- • **Teoria e Kontratës Sociale:** – populli në një kontratë me çdo pjesëtar të shoqërisë dorëzon disa liri personale për të garantuar sigurinë apo mirëqenien e të gjithëve.

Shteti

- • Njësia politike dominuese në botë.
- • Te njohura sipas OKB-se, anetare te saj 193 shtete në botë.
- – Ka shtete me mbi 1.3 miliardë banorë si Kina dhe të tjerë si Andora me popullsi afro 80 mijë banorë
- Shtetet shpesh quhen si **kombe** apo **vende**

Ndër **karakteristikat e tij mund të** reshtohen katër:

- **Popullsia** (njerëzit që e përbëjnë atë)
- **Territori** (me kufi të përcaktuar dhe të njohur)
- **Sovraniteti** (fuqia për të udhëhequr vetveten)
- **Qeveria** (Ne kushte demokratike, institucioni i qeverisjes i organizuar politikisht nga populli)

Ç' është Fuqia (Pushteti)?

- **Fuqia** është kapaciteti për të prodhuar efekte apo pasoja, duke kontrolluar apo ndikuar vendime, akte apo sjelljen e individëve dhe grupeve.
- **Fuqia arrihet duke zbatuar apo shfrytëzuar:**
 - Forcën fizike dhe koercivitetin
 - Burimet dhe pasuritë (paranë)
 - Bindjen, karizmën dhe udhëheqjen
- **Fuqia Politike** është ajo e lidhur me vendime kolektive, me akte dhe sjellje konkrete - kjo është **qeveria** (qeverisja).
- **Sot fuqia e bute dhe e forte- soft power and hard power- kombinimi i tyre: smart power**

Detaje te tjera kohore.

- Sipas një politologu amerikan Robert Dahl, **fuqia politike lidhet në radhë të parë me vendimmarrjen, duke e konsideruar atë si burim dhe tregues bazë të fuqisë, pushtetit.** Ndryshe prej tij, pak më vonë, dy politologë të tjerë Peter Bachrach dhe Morton Baratz, e konsideruan këtë përcaktim si tepër të thjeshtëzuar, prandaj dhe përfshinë një përmasë të dytë të fuqisë, atë **të elitës tekniciene që punon “prapa dyerve”, larg syve të publikut që është pjesë e konsiderueshme e pushtetit mbi shoqërinë.** Steven Lukes, ka futur së fundi përmasën e tretë, që lidhet me **formësimin e preferencave** dhe që përbën kështu një aspekt të rëndësishëm të fuqisë normative në politikë. Këto 3 dimensione pranohen sot **si aspekte përcaktuese të pushtetit politik.**
- Një pikëpamje radikale alternative e burimit të fuqisë politike ka të bëjë me formulën: **“informim plus autoritet”** si një përbërës konkret i ushtrimit të fuqisë. Pra, fuqia politike lidhet ngushtë me **informimin.** Bile, sipas **Bejkonit (Francis Bacon): “Nam et ipsa scientia potentia est” (vetë njohja është fuqi),** në kuptimin e autoritetit që të jep. Dhe, nga ana tjetër, **ata që e ushtrojnë autoritetin në injorancë apo më saktë duke e shfrytëzuar injorancën** nuk janë të pushtetshëm (të fuqishëm), sepse ata nuk i realizojnë dot synimet e tyre dhe mbi të gjitha ndeshin një kontroll minimal (ose aspak fare) mbi efektet e pasojat e **shfrytëzimit të gabuar te autoritetit të tyre.**
- Një nga përkufizimet më të njohuar mbi pushtetin politik të periudhës post-moderne ndoshta është dhe ai i **Fukosë (Michel Foucault).** P.sh., në veprën e tij **“Disiplinë dhe dënim”** ai arrin tek pikëpamja se **fuqia është organike brenda shoqërisë.** Sipas saj, fuqia politike është më e ndjeshme dhe pjesë e një serie kontrollesh sociale dhe ndikimesh normalizuese nëpërmjet institucionesh historike, ku bëhen dhe dallimet e veprimeve normale ndaj aty anormale . Ai arrin deri aty sa ta karakterizojë fuqinë si **“veprim mbi veprime” (une action sur des actions),** duke synuar të argumentojë që fuqia është një lidhje midis shumë aspektesh, në një shndërrim të vazhdueshëm si në filozofinë e Niçes (Friedric Nietzsche), apo akoma që fuqia në shoqërinë njerëzore është pjesë e një procesi trajnimi e kultivimi për të gjithë individët, nga i pari (presidenti, kryeministri) tek njeriu i pastrehë, që luajnë rolin e tyre brenda strukturës së fuqisë së shoqërisë. Kundër tij është shprehur Habermas (Jürgen Habermas). Sipas këtij të fundit, **në lidhjet e fuqisë është plotësisht i mundshëm arritja e konsensusit në debat mbi disa rregulla fundamentale, për të ndërtuar në këtë mënyrë një dialog transparent dhe demokratik.**
- Nuk mund të mohohet se fuqia politike mund të kuptohet si një dukuri në shndërrim dhe që shndërron në konvergjencën midis lidhjeve dhe ndërveprimeve midis shtetit, bashkësie të udhëhequra apo jo dhe forcave të globalizimit. Madje, **në një kuptim të thellë rendi global i shtetit-komb është një pengesë e thellë e vetë procesit të globalizimit apo e qeverisjes globale.**

Kushtetuta – disa parime

Struktura e kushtetutës

- Preambula
 - Pohon qëllimet kryesore
- Detajim për çdo degë të veçantë të qeverisjes (1-3) dhe objektiva kryesore.
- Ndarja e fuqisë dhe kontrolli- balancimi.

Parimet kryesore. Me qëllim, por dhe për arsye praktike konsiderohet si një dokument i vërtetë: Pse kjo? Një rrugë për konsensus. Në vend të detajeve të vogla, **formulohen parime kryesore** për qeverisjen e vendit.

Sovraniteti popullor

- Populli është i vetmi burim i pushtetit qeverisës
- Pushteti merret nga populli.

Ndikimet politike informale

Qytetarët
Pjesëmarrja
Votimet
Anketimet
Opinionet

Grupet
e interesit

Partitë
Politike

Media

Sistemi Kushtetues Amerikan

Institucionet e vendimnarrjes formale

Dega Legislative
Dega Ekzekutive
Presidenti
Kabineti
Burokracia
Dega Juridike


Shtetet

Rrjedhimet - daljet politike

Liritë Civile
Të Drejtat Civile
Politika Ekonomike
Makroekonomia
Mikroekonomia
Ekonomia Mjedisore
Politika Sociale
Mirëqenia
Edukimi
Politika e Sigurimit
Kombëtar
Politika e Mbrojtjes
Politika e Jashtme

Hyrjet

Çiftëzimi i kundërt



Cili i ushtron pushtetet?

- **Diktatura** – *fuqitë ushtrohen nga një individ i vetëm apo grup i vogël.*
- **Demokracia** – *kur pushtetet mbahen nga një shumicë e popullit, duke respektuar pakicën*

Koncepte themelore të demokracisë

- Vlerat e individit
- Barazia e të gjithë personave
- Udhëheqje e shumicës, të drejta të pakicës
- Domosdoshmëria e kompromiseve
- Liritë dhe të drejtat individuale





Përkufizim: Një qeverisje është një kombinim strukturimesh, ligjesh dhe zakonesh nëpërmjet të cilëve njerëzit jetojnë së bashku.



Çfarë mund të ndodhë po të mungojnë rregullat?

Sepse njerëzit jetojnë në grup, në bashkësi apo komunitet del si domosdoshmëri krijimi i rregullave dhe ligjeve, pra dhe një qeverie për të garantuar anëtarët e këtij komuniteti që të jetojnë në siguri dhe paqe.



Institucionet

- Pra, studimi i fuqisë është dhe **studimi i atij individi apo grupi që vendos.**
- **Institucionet politike** janë zyrat afatgjata të autoritetit, strukturat, rregullat dhe procedurat për marrjen dhe realizimin e vendimeve kolektive (qeverisëse), arritjen e qëllimeve konkrete politike, ekonomike, kulturore, etj.
 - **Institucionet politike përcaktojnë cili vendos**
 - **Institucionet politike përcaktojnë se cili influencon dhe cili vendos.**

Institucionet (tipe)

- **Institucionet monarkike**
 - Vendos Mbreti, i influencuar nga aristokracia, fisnikët dhe ngjarjet.
- **Institucionet diktatoriale**
 - Vendos lideri (kryetari), i ndikuar nga partia e tij dhe ngjarjet.
- **Institucionet demokratike apo republikane**
 - Vendimet janë në përputhje me bazen ligjore, kushtetutën dhe ngjarjet (evolucioni i tyre).

Mbi qeverisjen:


Çfarë është një qeverisje apo qeveri?

- • Qeverisja- Institucioni nëpërmjet të cilit një shoqëri realizon apo aplikon **politikat publike**.
- • Çdo qeveri (qeverisje) ka dhe ushtron 3 lloje pushtetesh –
- – **Fuqinë legjislative** – harton ligje dhe projektton politika publike
- – **Fuqinë ekzekutive** – ekzekuton, imponon dhe administron ligjet e miratuara
- – **Fuqinë juridike** – interpreton ligje dhe zgjidh konflikte apo kundërshti midis institucioneve, grupeve apo individëve.


Klasifikim qeverisjesh

- Sipas pjesëmarrjes:
 - – **Demokracitë**
 - • **Demokracia e drejtpërdrejtë** (Athina antike, qyteti i New England)
 - • **Demokracia përfaqësuese** (p.sh. sistemi federal amerikan)
 - – **Diktaturat**
 - • **Autokracia** – pushtet i ushtruar nga një individ i vetëm (Korea e Veriut)
 - • **Oligarkia** – pushtet i ushtruar (i mbajtur) nga një grup i vogël (Kina)
- • **Shpërndarja gjeografike e fuqisë**
- – **Qeverisja unitare** – të gjitha pushtetet ushtrohen nga një agjenci qendrore (Britania e Madhe)
- – **Qeverisja Federale** – pushtetet ndahen midis një qeverie qendrore dhe disa qeverive lokale (SHBA)
- – **Qeverisja konfederative** – një lidhje shtetet të pavarura – ku agjencia qendrore ka fuqi tepër të kufizuar (ne fillim SHBA nën artikujt e konfederatës dhe të shteteve konfederative të Amerikës.
- **Me ilustrimin e tyre do te merremi me gjate ne Kap. II.**


Tendencia te demokratizimit ne bote 1955-2000




Tendenca rajonale te demokratizimit, 1955-2000




Afrika




Azia




Australia



Europa



Amerika e Veriut & Amerika Qendrore



Amerika e Jugut



Demokracia semi-direkte: Sistemi politik zviceran i ka te bashkuara elementet e demokracise direkte dhe i asaj parlamentare (perfaqesuese)

- Demokracia direkte qe mbizoteron ne Zvicer ndryshon nga demoracia perfaqesuese ne ShBA apo Indi, ku populli i delegon fuqine te zgjedhurve te tyre. Ne sistemin politik zviceran ndeshen te ballancuara: **ajo direkte, ajo indirekte dhe ajo parlamentare, prandaj shpesh demokracine zvicerane e konsiderojme si pasqyrim te demokracise gjysme-direkte.**
- Nga Asambleja Federale zgjidhen **7 anetare te Keshillit Federal** nepermjet nje sistemi (indirekt) zgjedhjeje brenda ne asamble. Nje nga anetaret e ketij keshilli mban postin e **presidentit te Zvices per nje periudhe njevjecare**. Ky sistem zgjedhje i presidentit midis 7 anetareve shpreh po ashtu nje model indirekt demokracie. (Krahasoni , p.sh., zgjedhjet presidenciale ne ShBA ose Indi!).
- Nga nje pjese e analizes politike, sistemi zviceran per zgjedhjen e kryetarit te shtetit eshte i thjeshte, pa veshtiresi dhe pa nderhyrje korruptive, aq me teper qe ky person qendron vetem per nje vit ne ate detyre. (**After all power corrupts power and absolute power corrupts absolutely!**).
- **Demokracine direkte per qytetarin ne Zvicer e ndeshim shume here ne vit: per ceshtje te nivelit federal, kantonal apo komunal.**
- Pas formimit te federates zvicerane ne 1848, grate nuk kishin te drejta politike. Keshtu deri vone vetem nje pjese e popullsise ne moshe ka marre pjese ne realizimin e demoracise direkte, derisa me se fundi kjo e drejte per grate gradualisht u fitua ne menyre kombetare te gjitha kantonet (me 1971).


Qeverisja presidenciale dhe ajo parlamentare

- – **Qeverisja Presidenciale** – degët ekzekutive dhe legjislative janë të veçuara. Ata janë të pavarura nga njëra tjetra dhe të barabarta (USA)
- – **Qeverisja Parlamentare** – dega ekzekutive është e zgjedhur nga dega legjislative (Britania e Madhe)

Qeverisja parlamentare dhe ajo presidenciale



Qeverisja ne France



Qeverisje e kufizuar

- Qeveria operon në **respektim të kushtetutës. Veprimet e saj duhet të mbështeten nga parimet kushtetuese. Ky është the thelbi i veprimit dhe “zbatimit të ligjit”. Askush nuk është mbi ligjin.**
- Një pjesë e konsiderueshme e kushtetutës amerikane ka të bëjë me atë që **ndalohet...**
(“**Congress shall make no law...**”)

Ne disa vende europiane kushtetuta perfshin ate
qe **lejohet...**

Sisteme qeverisje:


Tre tipe
qeverisjeje:

- Unitare,
- Federale
- Konfederale.


UNITARY SYSTEM



FEDERAL SYSTEM



CONFEDERAL SYSTEM (or CONFEDERATION)



Sistemi unitar

- Shtet unitar eshte shteti (vendi) qe qeveriset nga ana kushtetuese **si nje njesi e vetme, me nje legjislature te vetme (me nje strukture legjislative te vetme).**
- Sistemi unitar ia jep **qeverisjes qendrore** te gjithë autoritetin apo pushtetet kryesore te shtetit.
- **Drejtimi i shtetit, i provincave dhe njesive lokale realizohet, krijohet e organizohet nen perkujdesjen e qeverise qendrore.**
- Qeverisjet jo qendrore kane vetem ato fuqi (pushtete) te caktuara nga qeverisja qendrore dhe vazhdojne te ekzistojne e funksionojne per aq kohe qe kane miratimin e qeverisjes qendrore.

Federalizmi

- Krahas ndarjes së fuqisë midis degëve të qeverisjes është po ashtu **ndarja e fuqisë midis qeverisë qendrore dhe qeverive të njesive (shteteve, Land-eve, rajoneve, kantoneve).**
- Fuqitë specifike u jepen njëkohësisht qeverive kombëtare (federatës) apo atyre lokale (për çdo shtet).

Sistemi federal (Federata)

- **Sistemi federal** është ai ku janë federuar disa shtete apo provinca: duke krijuar një strukturë të vetme të unifikuar qeverisëse për të gjithë territoret përberëse.
- Në një qeverisje ku zbatohet (shfrytëzohet) një sistem federal, fuqite apo pushtetet qeverisëse ndahen **midis qeverisë (qeverisjes) qendrore dhe qeverive (qeverisjeve) rajonale**.
- Qeverite rajonale kanë një shkallë të caktuar autonomie.
- Nga pikepamja kushtetuese, qeverisjet rajonale ruajnë apo kanë **sovranitetin e tyre kushtetues**.
 - Në sistemet federale, asamblëte e shteteve që përbejnë federatën kanë **një ekzistencë kushtetuese**. Ato ushtrojnë një mori funksionesh kushtetuese, që nuk mund të ndryshojnë apo të amendohen në mënyrë të njëanshme nga qeverisja qendrore.

Sistemi konfederal (konfederata)

- **Konfederate** është bashkimi i një numri shtetesh sovrane, shpesh të krijuar fillimisht me anë të një marreveshje apo traktati, dhe më tej edhe duke adoptuar një kushtetute të përbashkët.
- Konfederatat fokusohen apo kanë të bëjnë me çështje kryesore e kritike si mbrojtja, politika e jashtme, tregtia e jashtme apo monedha e përbashkët.
- Në terma bashkëkohore, konfederata kufizohet zakonisht në një bashkim permanent shtetesh sovranë për aksione të përbashkëta ndaj shteteve të tjera.
- Qeveria qendrore në një konfederate është e dobët, ndërsa pushtetet apo fuqitë e vërteta ndodhen në duart e njësive nën-kombetare.

Shembulli i perziere i BE-se

Regjim unik:

- **Federal:** Parlamenti, Gjykatat
- **Konfederal:** Keshilli i Ministrave

Motivimi qendror eshte bere shume me i gjere, ndryshe nga ai fillestar per ruajtjen e paqes dhe bashkepunimin midis vendeve. Nga bashkimi ekonomik eshte kaluar gradulisht **ne ate politik**. Aktualisht synohet te behet dicka ne aspektin e bashkimit financiar (fiskal).

